



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 26. 01. 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Enis Kervan, Ramadan Avdiu, Eqrem Kryeziu, Lutfi Haziri, Ramë Buja, Nexhat Daci dhe Ardian Gjini.

Munguan: Xhavit Haliti, Ibrahim Gashi dhe Dragisa Miric.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Dëshmi e z. Skënder Hyseni , ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës,**
- 3. Raporti i vizitës së Komisionit në Republikën e Shqipërisë,**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

U miratua procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Dëshmi e z. Skënder Hyseni , ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës

Sabri Hamiti – E përshëndeti praninë e ministrit Skënder Hyseni. Shtoi se është këtu me ftesë të Komisionit, që të na njoftojë për zhvillimet në sferën e politikës së jashtme, si dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Skënder Hyseni - Ministër i Punëve të Jashtme paraqitjen e tij e përqendroi kryesisht në ndërtimin e strukturës së Ministrisë dhe të shërbimit diplomatik e konsullor të Kosovës, në procesin e mëtejshëm të njohjeve ndërkombëtare të Kosovës dhe përparimin në rrafshin e nënshkrimit të marrëveshjeve. Tha se Ministria e Punëve të Jashtme po vazhdon ta ngrejë strukturën e saj dhe ky proces është duke ecur mirë. Së shpejti pritet të shpallet konkursi për dhjetë ambasadat ekzistuese dhe për dymbëdhjetë të tjera. Ky vendim është marrë pas analizave të bëra se Kosova ka nevojë të përfaqësohet sa më parë me ambasada në shtetet: Mali i Zi, Maqedoni, Slloveni, Kroaci, Bullgari, Hungari, Çeki, Suedi, Holandë, Portugali, Kolumbi dhe Japoni. Këto ambasada gjer në fund të këtij viti do të jenë plotësisht funksionale dhe të kompletuara me staf. Po ashtu e njoftoi Komisionin se nga 17 shkurti do të ketë

njohje të reja. Në vazhdim tha se Ministria e Punëve të Jashtme e ka hartuar një plan të kontakteve të lobimit dhe jemi në pritje lidhur me 38 nota për takime me vende të ndryshme. Ndikim negativ në procesin e njohjeve, në mënyrë të tërthortë kanë pasur krizat globale, kriza në Rripin e Gazës, prej nga 4 shtete të Gjirit, që është dashur të na njihnin, për shkak të zhvillimeve të atjeshme, nuk e kanë marrë në shqyrtim çështjen e njohjes së Kosovës.

Nënshkrimi i marrëveshjeve me vendet e tjera, sidomos të atyre dypalëshe, ka ndikim pozitiv. Përveç tjerash ky do të jetë argument i fuqishëm në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Këtë vit do t'i kushtohet rëndësi e veçantë nënshkrimit dhe negociimit të marrëveshjeve dypalëshe.

Nexhat Daci - Mendon se Ministria e Punëve të Jashtme me kapacitetet e saj të tërësishme, nuk mund t'i përmbushë nevojat e Republikës së Kosovës. As qeverisja nuk ka politikë të jashtme konsistente që do të mund të ishte produktive dhe do t'i plotësonte aspiratat. Sa i përket çështjes së lobimit në buxhetin e Kuvendit nuk ka fare mjete, ndërsa diplomacia kuvendore njihet kudo si diplomaci shumë më lehtësuese se sa ekzekutivi, sepse mund të depërtojë më lehtë nga formalitetet se sa Qeveria. Lidhur me delegacionet që caktohen në kuadër të delegacioneve parlamentare, duhet ta përbëjnë një sintezë të realitetit politik të shtetit të Kosovës, pa përqendrim sipas partive politike, pozitës ose opozitës, sepse çështja e lobimit është çështje kombëtare dhe është vullnet i të gjithëve që sa më shumë vende të na njohin.

Ardian Gjini - Në diskutimin e tij tha se e përkrah radhitjen e vendeve për hapjen e ambasadave të fazës së dytë. Kjo dhe emërimi i ambasadorëve do të mund të bëheshin shumë më parë. Institucionet bartëse të politikës së jashtme, si Qeveria dhe MPJ-ja, nuk kanë bërë aq sa kanë pasur mundësi të bënin. Është e vërtetë se nuk është e lehtë të depërtohet në vendet që nuk na kanë njohur, por do të mund të arrihej efekti edhe nëpërmjet vizitave në vendet që na kanë njohur, p.sh.: të bëhet një vizitë në Hungari, ku do të shpreheshin falënderimet për njohje. Në të njëjtën kohë do të arrihej efekti i lobimit në mënyrë indirekte për njohje të Kosovës.

Ramadan Avdiu - Duke u ndërlidhur me njoftimet e ministrit Skënder Hyseni, tha se Ministria duhet ta ketë një strategji të veprimit për njohjet dhe Komisioni duhet të njoftohet për atë plan, që të bëjë përpjekje për të gjetur forma që të jetë më i pranishëm në skenën ndërkombëtare.

Mendon se do të ishte mirë t'u dërgohej notë diplomatike të gjitha shteteve që nuk na kanë njohur, me kërkesë për njohje, përfshirë edhe Rusinë e Serbinë. Po ashtu të kërkohen takime edhe me ministritë e rëndësishme dhe me ministri të vendeve të tjera, që na kanë njohur, për qëllime bashkëpunimi. MPJ-ja, po ashtu do të duhej ta bënte një koncept që të kushtëzohej bllokimi i Serbisë në proceset integruese, me njohjen e Kosovës, sepse pretendimet territoriale ndaj një shteti tjetër janë parim bazë i BE-së, sipas të cilit asnjë shtet nuk mund të inkuadrohet në mekanizmat e tij.

Në vazhdim kërkoi të informohej lidhur me përgatitjet për procesin gjyqësor në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe pyeti a është e nevojshme ndihma e Komisionit për këtë çështje.

Lutfi Haziri - Tha se gjatë vizitës që e kam pasur në Francë i kam kuptuar rolin dhe vështirësitë që i përcjellin përfaqësuesit e misioneve tona atje. E mbështeti angazhimin për hapjen e ambasadave të reja. Kërkoi të informohej se me hapjen e ambasadave të reja, si në Japoni ose në Kolumbi, a parashihet të mbulohet edhe ndonjë shtet tjetër për përfaqësimin e interesave tona, apo e drejta e përfaqësimit tonë t'i bartet ndonjë shtet tjetër në pamundësi që të jemi të përfaqësuar gjithkund. Në këtë drejtim mendon se duhet të mbulohen edhe Zelanda e Re, Australia dhe Lindja e Mesme për të na përfaqësuar në Konferencën Islamike. Mbajta e Konferencës së Shteteve të Painkuadruara në Beograd, është në përgatitje e sipër dhe se mospërqendrimi ynë në këtë konferencë do ta vendoste edhe një barrikadë më të madhe për njohjen e pavarësisë nga këto shtete. Në vazhdim kërkoi të njoftohej sa ishte agjenda jonë e lidhur me kontratën për ta paraqitur shtetin e ri të lindur në Evropë, si dhe paralajmërimi i kryetarit të AKR-së për njohjen nga 4 shtete a është në koordinim me MPJ-në.

Lidhur me konkurset për ambasadorë tha është mirë të shpallen më shpejt. Bëri vërejtje për kushtin ligjor të njohjes së gjuhës së vendit, ku akreditohet ambasadori. Në fund propozoi që kryetari i Komisionit ta dërgojë një telegram ngushëllimi me rastin e vdekjes së mikes së madhe të Kosovës, Christine Von Kohl.

Eqrem Kryeziu - Tha se raportet diplomatike janë kapitulli më i ri në veprimtarinë shoqërore të Kosovës dhe hyrja në raporte strukturash shtetërore është diçka krejt e re. Deklarimit të ministrit se është një përkrahje e fuqishme e qeverive të rëndësishme dhe një ndihmë për Kosovën, i besoj, sepse ata e dinë shumë mirë se çka do të thotë formimi i një shteti. Sa u përket ankesave të të ngarkuarve me punë për vështirësitë e tyre, është normale të kërkojnë kushte më të mira për punë. Si rast të preokupimit të secilit për njohje ndërkombëtare të Kosovës, e përmendi vizitën në Turqi. Kërkesë e parë e kryetarit të Kuvendit në këtë shtet, përveç marrëveshjeve të tjera, ka qenë lobimi për njohjen e Kosovës.

Sabri Hamiti – E autorizoi deputetin Lutfi Haziri për dërgimin e telegramit ngushëllues me rastin e vdekjes së mikes së Kosovës Christine Von Kohl. Në vazhdim kërkoi të informohej nga ministri se kur do të kompletohet MPJ-ja dhe kur do të hapet konkursi për 22 pikat e përmendura të përfaqësimit jashtë.

Skënder Hyseni - Duke u ndërlidhur me pyetjet e anëtarëve të Komisionit, pajtohet plotësisht me vlerësimet e z. Daci se MPJ-ja nuk ka kapacitete të mjaftueshme, sepse është krijuar rishtas. Sa i përket diplomacisë parlamentare tha se e përkrah çdo nismë të saj. Emërimi i ambasadorëve nuk ka mundur të bëhet më parë për shkak të vështirësive për nxjerrjen e kornizës ligjore për shërbimin e jashtëm. Sa u përket vështirësive që i kanë të ngarkuarit me punë, është normale të kenë vështirësi, por për ta kryer punën e tyre ata kanë kushte ideale. Të të ngarkuarve me punë u është dërguar lista në të cilën shihet se edhe në cilat vende të tjera duhet të llobojnë. Lidhur me mendimin se duhet të vizitohen edhe vendet që na kanë njohur, ka pasur vërejtje gjatë interpelancës, për arsye se e ka vizituar Çekinë, ndërsa vendeve, që ende nuk na kanë njohur, vazhdimisht u dërgojmë nota me kërkesë për vizitë me temë për njohje. Çështja e shpejtimit të hapit të Serbisë për stabilizim-asociimin, është temë bosht e çdo takimi që mbahet në MPJ.

Njoftoi se një numër vendesh në botë, që na kanë njohur, e kanë shprehur gatishmërinë për të bërë deklaratë me shkrim në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në të mirë të Kosovës.

Në fund shtoi se konkursi për ambasadorë do të shpallet rreth 15 shkurtit. Secili nga 22 ambasadorët e Kosovës do të mbulojë edhe vende të tjera.

3. Raporti i vizitës së Komisionit në Republikën e Shqipërisë

Komisioni e miratoi Raportin e vizitës së delegacionit të Komisionit në Republikën e Shqipërisë.

4. Të ndryshme

Sabri Hamiti - I njoftoi anëtarët e Komisionit se mbledhja e radhës do të mbahet të mërkurën, më 28 janar, me ç'rast do të shqyrtohen Raporti vjetor i punës së Komisionit dhe Projektligji për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetje të Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti